



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 242, dt. 23.11.2015

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 23.11.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për ndërtimin “Impianti i pasurimit të mineralit të kromit”, Tërnovë, Bashkia Bulqizë.
 2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e banesës së Mustafa Shehut, fshati Zerqan, Bulqizë, sipas projekt-preventivit të hartuar nga specialistët e DRKK-së Shkodër, Sektori Dibër.
 3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI